



Qendra per Qeverisje te mire



## **ANKETIMI I PERCEPTIMIT QYTETAR**

(Ky anketim është mbështetur nga Lëviz Albania)

Në bashkëpunim me :


- ❖ “Gruaja Naftëtare në Fokusin e Zhvillimit” ;
- ❖ “ Klubi Rinor Ambientalist Blerimi”;
- ❖ “Ndihmë Sociale Gruas Kryefamiljare”;
- ❖ Dega Amaro –Drom me seli në Kuçovë.

## Anketimi


Qendra për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me “Gruaja Naftëtare në Fokusin e Zhvillimit”, “ Klubi Rinor Ambjentalist Blerimi” , “Ndihmë Sociale Gruas Kryefamiljare” dhe dega Amaro –Drom me seli në Kuçovë, realizuan 320 anketime në të gjithë bashkinë e re Kuçovë. Grupi i punës përzgjedhi 8 kryetarë grupi të cilët ishin edhe Kryetarët e grupeve të verifikimit. Secili nga kryetarët e grupeve përzgjedhi edhe 2 persona të tjerë dhe të tre së bashku anketuan 40 persona, banorë të bashkisë Kuçovë. Pra anketimet u realizuan nga 24 persona duke shmangur në këtë mënyrë subjektivizmin. U kërkua gjithashtu që anketa të përmbante emrin dhe mbiemrin e personit që do të anketohet. Në anketim u përfshinë 160 femra dhe 160 meshkuj me moshë që varioje nga 16 deri në 80 vjeç.

Meqenëse bashkia e re e Kuçovës përbëhet nga ish-bashkia Kuçovë dhe 3 ish-komuna, u vendos që anketimi të realizohej me 200 anketime në ish-bashkinë e Kuçovës e cila ka numrin më të madh të banorëve dhe 120 në 3 ish-komunat që sot janë njësi administrative pra respektivisht 40 në çdo njësi ( Kozare, Perondi, Lumas).

### 1. Anketimi sipas njësive administrative.




## 2. Anketimi sipas statusit të individëve që u anketuan




Siç shikohet pjesa dërmuese janë nxënës, studentë ,fermerë, të vetpunësuar, pensionistë etj... dhe një pjesë e madhe ( 109 persona) janë të papunë. Gjithashtu janë anketuar 35 persona nga administrata lokale dhe qendrore, 23 biznesmenë, 14 anëtar të shoqërisë civile dhe 4 anëtarë të Komisioneve qytetare.Kjo përzgjedhje është bërë rastësore nga 24 intervistuesit.

## 3- Niveli i Arsimit




Kjo përzgjedhje është bërë rastësore por ka pak a shumë edhe strukturën arsimore të bashkisë Kuçovë. Janë anketuar 71 persona me arsim të lartë, 190 me arsim të mesëm dhe 59 arsim të detyrueshëm.

4-Opinionin në përgjithësi mbi nivelin e shërbimit të pastrimit në bashki ;




Opinionin në përgjithësi është pozitiv; pra 57 % e të anketuarve mendojnë se niveli i shërbimit të pastrimit është kënaqshëm , i mirë dhe shumë mirë, 21 % mendojnë se është mjaftueshëm dhe vetëm 21 % shprehen dobët.

5-Opinionin mbi nivelin e shërbimit të pastrimit në afërsi të banesave ;




Opinionin në shërbimin e pastrimit në afërsi të banesave është pak a shumë i njëjtë me opinionin në përgjithësi..

6-Njohuri mbi vendimet e masat e bashkisë për menaxhimin mbetjeve.




Shikohet qartë se 36 % e të anketuarve nuk janë në dijeni mbi vendimet dhe masat që merr bashkia. Pra në të ardhmen duhet që bashkia të nxisë komunikimin me qytetarët me të gjitha format e mundëshme.

7-Njohuri mbi buxhetin e vendosur prej bashkisë për menaxhimin e mbetjeve.




Evidentohet që 54 % e banorëve të Kuçovës nuk kanë njohuri mbi buxhetin e bashkisë. Pra përsëri duhet synuar që të gjenden forma sa më të larmishme për të rritur komunikimin me banorët.

#### 8-Pagesa e tarifës së pastrimit



Shikohet se 20 % e të anketuarve e pranojnë hapur dhe indirekt se nuk e paguajnë tarifën e pastrimit. Kjo kërkon të merren disa veprime dhe aksione të kombinuara që as edhe një banor të jetë mospagues i tarifës së pastrimit.

#### 9- Pagesa në muaj për një banor për pastrimin e mbetjeve



Këtu shikohet që banorët nuk kanë dijeni për pagesën e tyre ndaj bashkisë. Mundet që personat e intervistuar nuk janë kryefamiljarë .

10-Mundësitë për ta paguar sasinë e tarifës së caktuar aktuale për mbetjet.






Diagrama tregon se banorët nuk e shikojnë si mundësi rritjen e tarifës për të përmirësuar shërbimin e pastrimit. Vetëm 9% e tyre janë dakord të shtohet gradualisht. Kërkohej sensibilizim të qytetarëve të kuptojnë se nuk mund të ketë përmirësime të dukshme në rast se nuk rritet tarifa e pastrimit.

11- Dijeni se kush e kryen shërbimin e pastrimit në bashki.




Ndonëse firma pastron qytetin e Kucovës dhe qendrat administrative çdo ditë, 55% e banorëve nuk janë në dijeni se kush e kryen këtë shërbim. Kjo situatë, gjithashtu, kërkon një informim sa më të detajuar të banorëve se vetëm në këtë mënyrë ata mund të jenë edhe vrojtues të parregullsive dhe të ngrenë zërin e tyre për përmirësimin e situatës.

12- Djeni se sa është fondi në lekë që bashkia përdor për shërbimin e pastrimit .



Një tregues kuptimplotë i padijenisë totale të banorëve për fondin që shpenzon bashkia për shërbimin e pastrimit.


13-Mendimi për formën e mbledhjes së tarifës së mbetjeve në bashki



Kjo kërkon një interpretim sepse nga njëra anë të intervistuarit nuk kanë shumë dijeni dhe nga ana tjetër kërkojnë përmirësimin e formës së mbledhjes së tarifës.




14-Dijeni mbi shpenzimet që mbulohen nga të ardhurat e tarifës familjare përkundrejt shumës së vendosur prej bashkisë.




Kjo është problem për tu sqaruar sepse afro 82% nuk janë në dijeni sa është fondi i bashkisë dhe nga ana tjetër 48 % e tyre shprehen shumë mirë, mirë, mjaftueshëm dhe kënaqshëm !

15-Niveli i përfshirjes komunitare në planifikim, në vendim marrje e në zbatim të këtij shërbimi.




Një pjesë e madhe e komunitetit ( 62,5 %) nuk përfshihet në vendimmarrje dhe kjo na bën të mendojmë se duhen të diversikohen format e pjesmarrjes së komunitetit në vendimmarrje.

16-Sa të mbrojtur ndjehen banorët nga dëmi që shkaktojnë mbetjet për shëndetin e individëve dhe familjeve.




Duhet një veprimtari e madhe ndërgjegjësimiti për të rritur ndjeshmërinë e banorëve për dëmin që shkaktojnë mbetjet.

17-Cila është pika më shumë e ndotur që ndikon mbi shëndetin e qytetarëve të bashkisë




Kjo tregon sensibilitetin e madh që kanë banorët për kazanët sepse i shohin çdo ditë dhe shpesh ato janë në gjëndje jo normale dhe ndonjëherë në gjëndje të mjerueshme.

18- Sa prej komunitetit kanë parë djegje të mbetjeve në ambient të hapur në vend-depozitim




Shumica e të anketuarve kanë parë djegje të mbetjeve pra një dukuri që duhet të ndalohet sepse dihet shumë mirë dëmi që shkakton në organizmat e gjalla djegja e mbetjeve.

19- Si është niveli i reagimit të banorëve për ndotjen e mjedisit ?




Ky është një tregues i kënaqshëm sepse 47 % e të anketuarve shprehen se banorët reagojnë. Por nëse banorët informohen në hollësi mbi shpenzimet e buxhetit, mbi mënyrën e mbledhjes dhe sasinë e tarifës si dhe nëse nxitet bashkëpunimi atëhere reagimi i banorëve do të jetë i një niveli më të mirë.

21-Shpresa në të ardhmen, se shërbimi do të ndryshojë për një nivel më të lartë në favor të qytetarëve:




Kjo hartë grafike na tregon që pjesa më e madhe e të anketuarve (57%) nuk shprejnë që shërbimi i pastrimit mund të ndryshojë. Bashkëbisedimi dhe bashkëpunimi bashki-komunitet-biznes duhet të rritet për të ndryshuar këtë mentalitet.

22- Sasia e pjesmarrjes së komunitetit në mbledhje të Këshillit bashkiak .




Vetëm 25 nga të 320 anketuesit kanë marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak. Përvoja tregon se nëse banorët nuk kanë interes personal atëherë ata nuk janë të interesuar në mbledhjet e Këshillit.

23- Sasia e diskutimeve mbi shërbimin e pastrimit në ndonjë mbledhje të Këshillit bashkiak.




Projekti i QQM-së synon që të nxisë Këshillin Bashkiak që të përfshijë në axhendën e tij diskutimin mbi shërbimin e pastrimit.

24 – Sasia e pjesëmarrjes në ndonjë komision këshillimor për mbetjet, të organizuar nga bashkia .




Evidentohet një rritje e pjesëmarrjes së komunitetit në komisionet e organizuara nga bashkia.

25- Sasia e diskutimeve mbi shërbimin e pastrimit në mbledhjet e këshillit bashkiak.




Sipas shifrave në grafikë, duhet që këshilli të nxisë bashkëpunimin me qytetarët në përmirësimin e shërbimit të pastrimit.

26- Pjesëmarrja në mbledhje të organizuar nga shoqëria civile/grupe interesi për pastrimin e mbetjeve




Ky është një tregues deri diku i kënaqshëm dhe projekti ynë synon të nxisë pjesëmarrjen e shoqërisë civile në pastrimin e mbetjeve.

27- Pjesëmarrja vullnetarisht për të pastruar rreth banesës së qytetarëve.



Ky është një tregues shumë positive dhe duhet të nxitet që të bëhet në mënyrë të rregullt sepse në këtë mënyrë banorët nuk do të lejojnë që të tjerë të ndotin mjedisin .

28- Sasia e banorëve që hedhin mbetje jashtë vendeve të caktuara.



Hedhja e mbetjeve jashtë vendeve të caktuara është një dukuri që shfaqet kudo po këtu duhet të synohet që me anën e aktiviteteve të projektit do të synohet që kjo dukuri të vijë duke u zhdukur.

31. Si informoheni nga vendimet që merr e bashkia.

Më poshtë do të gjeni renditjen sipas mesatares së përdorimit ku shikohet se media sociale po rritet dhe duhet të përdoret gjithmonë e më shumë nga bashkia dhe shoqëria civile.



Pyetja 32

Për të mbajtur një bashki më të pastër cilat mendoni se janë instrumentat që duhen përmirësuar?

Prioritete janë vendosur në mënyrë numerike.

1. Nxitja e kulturës dhe ndërgjegjësimi qytetar.
2. Përmirësimi i pikave të hedhjes së mbeturinave.
3. Vendosja e një numri më të lartë të koshave.
4. Pjesmarrja e njerëzve në ruajtjen e pastërtisë.
5. Vendosja e gjobave për personat që hedhin mbetje jo në vëndet e caktuara.
6. Shmangien e grumbullimit të mbetjeve jashtë kazanëve.
7. Modernizimi i shërbimeve të pastrimit.
8. Rritja e shpeshmërisë (frekuencës) në mbledhjen e mbetjeve.
9. Parteriteti Publik Privat për mbetjet e riciklueshme.



## 10. Vendosjen tarifës të barabartë me koston e duhur.

Pyetja 33- Cilat mendoni se është mënyra më e mirë për të bashkëbiseduar me qytetarët në përmirësimin e shërbimit të pastrimit në bashkinë tuaj.

Sipas anketimit kemi vendosur më poshtë prioritet në mënyrë numerike .Pjesa dërmuese e banorëve mendojnë se mbledhjet e hapura si në për lagje apo nëpër shkolla janë mënyra më e mirë për të bashkëbiseduar në përmirësimin e shërbimit të pastrimit. Kjo është parashikuar nga projekti dhe do të organizohen 16 tryeza të rrumbullakëta. Projekti synon që do të hartojë një raport të shkurtër si fletë-palosje për të nxitur komunitetin në përmirësimin e pastrimit.

1. Me mbledhje të hapura me banorët.
2. Me nxënës e mësues në shkolla.
3. Me fletëpalosje.
4. Me anën e medias sociale ( face-book twitter..).
5. Me faqen ëeb të bashkisë.
6. Me telefon.
7. Me email.

Përgatiti : A.Kurti , K. Gega, F.Hodaj